

**20170541041**

## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), dhe neni 114 nga Ligji për Banka ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

### **VENDIM PËR KONTROLLIN E AUTENTICITETIT DHE PËRSHTATSHMËRISË, KUSHTET DHE MËNYRA E KTHIMIT TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE NË QARKULLIM DHE MËNYRA E MBIKËQYRJES**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1. Me këtë vendim rregullohen mënyra e kontrollit të autenticitetit dhe përshtatshmërisë së kartëmonedhave dhe monedhave (në tekstin e mëtejme: paratë), kushtet dhe mënyrën e kthimit të tyre nga bankat dhe shoqëritë për furnizim me para të gatshme (në tekstin e mëtejme: qendrat për para të gatshme) në qarkullim dhe mënyra e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij vendimi.

2. Terme të caktuara brenda këtij vendimi kanë kuptimin si vijon:

- "Para autentike" janë paratë që posedojnë karakteristikat themelore të përcaktuara me rregulloren e Bankës Popullore;
- "Kontrolli i autenticitetit të parave" është procedurë e kontrollit të parave për dallimin e ekzemplarëve të parave për të cilat ekziston dyshim se janë të falsifikuara;
- "Para të përshtatshme për qarkullim" janë paratë të cilat janë kontrolluar nga aspekti i autenticitetit dhe të cilat i plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga Banka Popullore që të jenë në qarkullim;
- "Para të papërshtatshme për qarkullim" janë paratë të cilat pas kontrollit të kryer janë vërtetuar se janë të dëmtuara dhe/ose të ngrëna nga përdorimi, ose janë paratë të cilat janë përpunuar me gabime dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për kthim në qarkullim;
- "Para e dyshimta" janë paratë për të cilat ekziston dyshim se në të gjitha ose në disa veçori të sigurisë dallohen nga paratë autentike;
- "Para të falsifikuara" janë paratë e definuara me Rregulloren e Bankës Popullore për përcaktimin e procedurës për zbulim dhe tërheqjen e parave të falsifikuara;
- "Përpunimi i parave" është procedurë për kontrollimin e parave nëpërmjet vërtetimit të autenticitetit të tyre, sasisë, klasifikimit dhe përzgjedhjen në para të përshtatshme dhe të papërshtatshme, në mënyrë që të mund përsëri të kthehen në qarkullim;
- "Përzgjedhja dhe klasifikimi i parave" është procedurë për kontrollin e autenticitetit dhe përshtatshmërisë së parave nëpërmjet makinave për përpunim të parave;
- "Makina për përpunimin e parave" janë pajisje të cilat operohen nga punonjës të trajnuar të bankave, qendrat për para të gatshme ose klientë të cilët kanë mundësi për identifikim automatik dhe ndarjen fizike e parave të dyshimta dhe të papërshtatshme nga paratë autentike dhe të përshtatshme, pa asnjë mundësi për të ndikuar në procedurën e klasifikimit dhe përzgjedhjes nga ana e punonjësit të trajnuar të makinës.
- "Testimi i makinave për përpunimin e parave" nënkupton procedurë për testimin e mënyrës së funksionimit të makinave nga ana e Bankës Popullore duke përcaktuar

autenticitetin, sasinë, klasifikimin dhe përzgjedhjen parave në bazë të procedurave të përcaktuara teknike;

– “Punonjës të trajnuar” janë të punonjësit e bankave dhe qendrave për para të gatshme të cilët e kanë kaluar trajnimin në Bankën Popullore dhe kanë marrë vërtetim për përpunimin manual të origjinalitetit dhe përshtatshmërisë së parave për qarkullim;

– “Përpunimi manual” është një vlerësim vizual i kontrollit të autenticitetit nga ana e punonjësve të trajnuar duke përdorur pajisjet për kontrollin e autenticitetit, si dhe kontrollin vizual mbi përshtatshmërinë e parave për qarkullim të mëtutjeshëm.

## II. KUSHTET DHE MËNYRA E PËRPUNIMIT TË PARAVE

3. Për përpunimin e parave, bankat dhe qendrat për para të gatshme duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

– Të posedojnë makina për përpunimin e parave;

– Makinat me të cilat do të bëhet përpunimi i parave të jenë të renditura në listën e makinave të testuara me sukses dhe të publikuara në faqen e internetit të Bankës Popullore; dhe

– Punonjësit të cilët kryejnë përpunimin e parave, detyrimisht duhet të kenë një dokument se kanë kaluar me sukses trajnimin e Bankës Popullore për aftësimin e përpunimit manual të parave dhe kthimin e tyre në qarkullim.

4. Bankat dhe qendrat për para të gatshme kryejnë përpunimin e parave në mënyrat në vijim:

– Me makinat e përpunimit të parave që janë të renditura në listën e makinave të të testuara me sukses nga Banka Popullore, dhe

– Me përpunimin manual të parave nga punonjësit e trajnuar.

### **Llojet e makinerive për përpunimin e parave**

5. Makinat për përpunimin e kartëmonedhave klasifikohen në dy kategori:

– Makinat me të cilat operojnë klientët e bankave; dhe

– Makinat me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar.

Makinat për përpunimin e kartëmonedhave duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme teknike në shtojcën I të këtij vendimi.

6. Makinat për përpunimin e monedhave klasifikohen në dy kategori:

– Makinat me të cilat operojnë klientët e bankave; dhe

– Makinat me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar.

Makinat për përpunimin e monedhave duhet që me siguri të plotë t'i identifikojnë ekzemplarët e dyshimtë të monedhave.

### **Testimi i makinave për përpunimin e parave**

7. Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara ta informojnë Bankën Popullore për instalimin e makinës për përpunimin e parave, para se të fillojë përdorimi i saj.

Bashkë me njoftimin, bankat dhe qendrat për para të gatshme detyrimisht dërgojnë një deklaratë nga prodhuesi, furnizuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i këtyre makinave në territorin e Republikës së Maqedonisë, me të cilën garantojnë se makina ka karakteristika të njëjta dhe ka një zgjidhje softuerike që mundëson përpunimin e parave në të njëjtën mënyrë si makina e llojit të njëjtë, e cila është publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore.

8. Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara të kërkojnë nga Banka Popullore t'i testojë makinat për përpunim të parave, nëse ato nuk gjenden në listën e makinave të testuara me sukses, e publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore ose nëse përdorin një zgjidhje softuerike e cila nuk është testuar, para se të fillojnë me përdorimin e tyre.

9. Banka Popullore kryen testimin e performancës të makinave për përpunimin e parasë në bazë të kërkesës së paraqitur nga banka, qendrat për para të gatshme, prodhuesi, furnizuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar i këtyre makinave në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Kërkesa duhet ti përfshijë të gjitha të dhënat e nevojshme në lidhje me performancën e makinës për përpunimin e parave.

10. Procedura e testimit të makinave për përpunim e parave nga ana e Bankës Popullore përfshin kontrollin e performancës së makinës duke kontrolluar autenticitetin, sasinë, klasifikimin dhe përzgjedhjen e parave në para të përshtatshme dhe të pa përshtatshme për qarkullim.

Procedura për testimin e makinave për përpunimin e parave nga ana e Bankës Popullore do të bazohet në ekzemplarët e parave të falsifikuara dhe parave të cilat janë të përshtatshme dhe të papërshtatshme për qarkullim.

11. Pas testimit, Banka Popullore lëshon certifikatë për kryerjen e suksesshme të testimit të makinës për përpunimin e parave. Certifikata lëshohet për një periudhë të kufizuar prej një viti, nga data e testimit të kryer. Pas mbarimit të vlefshmërisë së certifikatës, makina përsëri i nënshtrohet testimit.

Makina e përpunimit të parave e cila nuk e kalon me sukses procedurën e kontrollit të performancës së punës së saj nuk mund të përdoret më tej.

Makinat mund të përdoren me përshtatje standarde të fabrikës, duke përfshirë azhurnimin e të gjitha versioneve të testuara, përveç nëse Banka Popullore nuk parasheh kriteret më të rrepta.

12. Banka Popullore krijon një listë të makinave të testuara me sukses për përpunimin e parave, të cilën e publikon në faqen e saj të internetit.

Bankat dhe qendrat për para të gatshme mund të vënë në përdorim makineritë e përpunimit të parave nëse ato janë të testuara dhe nëse janë renditura në listën e publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore.

13. Pas çdo përmirësimi softuerik ose harduerik të makinerive për përpunimin e parave të cilat janë testuar me sukses, banka, qendra për para të gatshme, prodhuesi, furnizuesi ose përfaqësuesi i autorizuar duhet të paraqesë një kërkesë për ritestim të performancës së makinës.

14. Banka Popullore nuk është përgjegjëse nëse një makinë për përpunimin e parave e cila me sukses e ka kaluar testimin nuk mund të kryen përpunimin e parave në mënyrën e përcaktuar me këtë vendim.

### **Trajnimi i punonjësve**

15. Banka Popullore kryen trajnimin e punonjësve të bankave dhe qendrave për para të gatshme për përpunimin manual të parave për shkak të rikthimit të tyre në qarkullim.

Punonjësit e trajnuar që e kanë kaluar trajnimin e kryer nga Banka Popullore kryejnë përpunimin manual të parave për qarkullim.

Deri në marrjen e statusit "punonjës i trajnuar", përpunim manual të parave për qarkullim mund të kryejnë edhe punonjësit të cilët punojnë nën mbikëqyrjen e një punëtori i cili posedon certifikatë prej Bankës Popullore si "punonjës i trajnuar". Këta punëtor detyrimisht e vizitojnë trajnimin për marrjen e statusit "punonjës i trajnuar" në afat jo më të gjatë se një vit nga dita kur kanë filluar përpunimin manual të parave në qarkullim.

### **Mënyra e trajtimit të kartëmonedhave të përpunuara**

16. Kartëmonedhat, të cilat kontrollohen me makina me të cilat operojnë punonjës të trajnuar, klasifikohen dhe trajtohen në përputhje me Aneksin II-a të këtij vendimi.

17. Kartëmonedhat, të cilat kontrollohen me makina me të cilat operojnë punonjës të trajnuar, klasifikohen dhe trajtohen në përputhje me Aneksin II-b të këtij vendimi.

Me kartëmonedhat për të cilat dyshohet se janë para të falsifikuara sipas klasifikimit të bërë në përputhje me Anekset II-a ose II-b të këtij vendimi, ose janë të përcaktuara me përpunim manual nga punonjësit e trajnuar, do të veprohet në përputhje me rregulloren me të cilën është themeluar procedura për zbulimin dhe tërheqjen e parave të falsifikuara.

18. Klasifikimi dhe përzgjedhja e kartëmonedhave për qarkullim bëhet në përputhje me standardet minimale të përcaktuara dhe procedurat nga Anekset III-a dhe III-b të këtij vendimi për përpunimin mekanik dhe manual të kartëmonedhave.

19. Kartëmonedhat që nuk janë kontrolluar dhe përpunuar në përputhje me procedurën e përpunimit të parave nuk lëshohen në qarkullim.

20. Bankat mund të kthejnë kartëmonedha në qarkullim me anë të makinave me të cilat operojnë klientët e bankave, dhe atë ato kartëmonedha për të cilat është bërë përpunimi me anë të makinave për përpunimin të kartëmonedhave dhe kartëmonedhat që janë dorëzuar drejtpërdrejtë nga Banka Popullore.

Kartëmonedhat përpunimi i të cilave është kryer nëpërmjet makinave për përpunim të kartëmonedhave dhe të cilat janë klasifikuar si autentike dhe të përshtatshme mund të kthehen në qarkullim.

21. Kartëmonedhat që përpunohen manualisht nga ana e punonjësve të trajnuar mund të kthehen në qarkullim vetëm nëpërmjet arkave të bankave.

22. Me përjashtim, kur një ngjarje e caktuar në mënyrë të konsiderueshme do ta pengojë furnizimin me kartëmonedha, vetëm në bazë të pëlqimit me shkrim nga Banka Popullore, bankat dhe qendrat për para të gatshme munden manualisht të kryejnë përpunimin e kartëmonedhave, të cilat mund ti kthejnë në qarkullim nëpërmjet makinave me të cilat operojnë klientët e bankës.

### **Mënyra e trajtimit të monedhave të përpunuara**

23. Bankat dhe qendrat për para të gatshme janë të obliguara të sigurojnë kryerjen e rregullt të procedurës për kontrollin e autenticitetit dhe përshtatshmërisë së monedhave të marra për qarkullim, si dhe kthimin e tyre në qarkullim.

24. Zbatimi i procedurës për kontrollin e autenticitetit dhe përshtatshmërisë së monedhave paraqet një proces me të cilin bankat dhe qendrat për para të gatshme vërtetojnë se monedhat janë autentike dhe të përshtatshme për qarkullim.

25. Me makinat për përpunimin e monedhave me të cilat operojnë klientët e bankave dhe punonjësit e trajnuar, në procedurën e përpunimit, duhet të sigurohet kontrolli i

autenticitetit të monedhave, ashtu që do të ndahen ekzemplarët e dyshimtë nga autentiket dhe do të bëhet përzgjedhje e monedhave të përshtatshme dhe të papërshtatshme për qarkullim.

Nëse bankat rishpërndajnë monedhat nëpërmjet arkëtarëve, ata duhet të sigurojnë përpunimin manual të parave nga punonjësit e trajnuar.

26. Monedhat, autenticiteti dhe përshtatshmëria e të cilave përcaktohen me procedurën e kontrollit në përputhje me këtë vendim, do të kthehen në qarkullim.

Monedhat për të cilat ekziston dyshimi se janë para të falsifikuara trajtohen në përputhje me rregulloren me të cilën është përcaktuar procedura për zbulimin dhe tërheqjen e parave të falsifikuara.

### III. MBIKËQYRJA E PËRPUNIMIT TË PARAVE

27. Banka Popullore mbikëqyrë bankat dhe qendrat për para të gatshme nëpërmjet kontrollit të drejtpërdrejtë, të plotë ose të pjesshëm në terren (me lajmërim ose pa lajmërim) me qëllim të kontrollit të përpunimit të parave. Gjithashtu kontrollohen edhe procedurat për performancën e makinave, trajtimin me paratë e kontrolluara dhe çdo përpunim manual të parave për qarkullim.

Banka Popullore mund të marrë ekzemplarët e parave të përpunuara nga bankat dhe qendrat për para të gatshme për t'i kontrolluar në lokalet e saj.

Në rast se nëpërmjet të kontrollit të drejtpërdrejtë përcaktohet, se veprohet në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi, Banka Popullore do të kërkojë nga bankat dhe qendrat për para të gatshme të eliminojnë parregullsitë brenda një periudhe të caktuar.

Në rast të ndonjë defekti në makinën e përpunimit të parave i cili nuk mund të rregullohet, Banka Popullore mund ta fshijë makinën nga lista e publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore.

Pas përfundimit të kontrollit, Banka Popullore përgatit një raport i cili i dorëzohet bankës dhe qendrës për para të gatshme.

Banka dhe qendra për para të gatshme kanë të drejtë të paraqesin ankesë ndaj raportit.

Ankesa duhet të dorëzohet brenda një afati kohor të cilin e përcakton Banka Popullore, dhe i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 5 ditë as më i gjatë se 10 ditë.

Së bashku me ankesën, banka dhe qendra për para të gatshme duhet të dorëzojnë njoftim për aktivitetet e planifikuara ose të ndërmarra në lidhje me tejkalimin e mospërputhjeve me rregulloret ose dobësitë e përcaktuara në raport.

Banka Popullore është e detyruar ti përgjigjet ankesës së raportit brenda 15 ditëve nga data e pranimit të ankesës, me çka zyrtarisht kontrolli do të konsiderohet i përfunduar, dhe raporti i përfunduar.

28. Për të monitoruar aktivitetet e bankave dhe qendrave për para të gatshme në lidhje me qarkullimin e parasë së gatshme, Banka Popullore mbledhë të dhëna nga bankat dhe qendrat për para të gatshme si dhe merr informacione për:

- llojin dhe numrin i makinave për përpunimin e parave;
- vendndodhjen e çdo makine për përpunimin e parave;
- të dhënat për paratë e përpunuara nga makinat për përpunimin e parave dhe paratë e përpunuara në mënyrë manuale.

Të dhënat nga bankat dhe qendrat për para të gatshme, për paratë e përpunuara paraqiten sipas numrit të copave (sasisë), shumës totale, sipas tremujorëve dhe sipas strukturës së denominimit.

Të dhënat dorëzohen në Bankën Popullore çdo tre muaj deri në ditën e 15-të pas skadimit të tremujorit të cilit i referohen.

#### IV. SHPENZIMET

29. Shpenzimet e krijuara për shkak të përmbushjes së detyrimeve që dalin nga ky vendim, i bartin bankat dhe qendrat për para të gatshme.

30. Banka Popullore nuk është përgjegjëse për shpenzimet e bëra nga bankat dhe qendrat për para të gatshme për shkak të ndryshimit ose karakteristikave të reja të sigurisë së parave.

#### V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

31. Guvernatori i Bankës Popullore miraton udhëzime për zbatimin e këtij vendimi.

32. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Vendimi për verifikimin e autenticitetit dhe përshtatshmërisë, kushtet dhe mënyra e kthimit të kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 112/15) pushon së qeni i vlefshëm.

33. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. nr. 02-15/III-1/2017  
27 prill viti 2017  
Shkup

Guvernator  
dhe kryetar i Këshillit  
të Bankës Popullore  
të Republikës së Maqedonisë  
Dimirat Bogov

## MAKINA PËR PËRPUNIMIN E KARTËMONEDHAVE

## 1. Kërkesat e përgjithshme teknike janë si vijon:

1.1. Për t'u kualifikuar si makinë për përpunimin e kartëmonedhave, makina duhet të jetë në gjendje t'i përpunojë kartëmonedhat, t'i klasifikoj dhe t'i ndajë fizikisht sipas klasifikimeve të tyre pa ndërhyrjen e punonjësit të trajnuar të makinës, në përputhje me anekset II-a dhe II-b. Makinat duhet të kenë numrin e duhur të daljeve dhe/ose mjete të tjera për të siguruar klasifikimin të sigurt dhe përzgjedhjen e kartëmonedhave të përpunuara.

1.2. Makineritë për përpunimin e kartëmonedhave duhet të kenë mundësi për përshtatje që të munden me siguri t'i zbulojnë paratë e reja të falsifikuara. Përveç kësaj, ato duhet të jenë adaptive në mënyrë që të mundësojnë vendosjen e standardeve pak a shumë kufizuese për përzgjedhjen dhe klasifikimin, nëse është e nevojshme.

## 2. Kategoritë e makinave për përpunimin e kartëmonedhave janë:

- makina me të cilat operojnë klientët e bankave; dhe
- makina me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar.

2.1. Makinat me të cilat operojnë klientët e bankave ku depozitohen para të gatshme dhe me të cilat mundësohet përcjellja e klientëve janë:

Tabela 1

1	<b>Makinat për depozitimin e parave të gatshme (Cash in Machines – CIMs)</b>	Këto makina u mundësojnë klientëve të bankave të depozitojnë kartëmonedha në llogaritë e tyre bankare duke përdorur kartelën bankare, por nuk kanë asnjë funksion për lëshimin e kartëmonedhave. CIM-të kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe mundësojnë ndjekjen e të dhënave të klientit të bankës – pronarit të llogarisë. Kontrollat e përshtatshmërisë për qarkullim nuk janë të detyrueshme.
2	<b>Makinat për depozitim dhe tërheqje të parave të gatshme (Cash recycling machines- CRMs)</b>	Këto makina u mundësojnë klientëve të bankave të depozitojnë dhe të tërheqin kartëmonedha në/nga llogaritë e tyre bankare, duke përdorur kartelën bankare. CRM-të kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave dhe mundësojnë ndjekjen e të dhënave të klientit të bankës – pronarit të llogarisë. Për tërheqje, makinat mund të përdorin kartëmonedha autentike dhe të përshtatshme të depozituara nga klientët e tjerë të bankës në transaksionet e mëparshme.
3	<b>Makinat e kombinuara për depozitimin e parave të gatshme (Combined cash in Machines – CCMs)</b>	Këto makina u mundësojnë klientëve të bankave të depozitojnë kartëmonedha në llogaritë e tyre bankare duke përdorur kartelën bankare, por nuk kanë asnjë funksion për lëshimin e kartëmonedhave. CCM-të

		kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe mundësojnë ndjekjen e të dhënave të klientit të bankës – pronarit të llogarisë. Kontrollat e përshtatshmërisë për qarkullim nuk janë të detyrueshme. Për tërheqje, makinat nuk i përdorin kartëmonedhat të depozituara nga klientët e tjerë të bankës në transaksionet e mëparshme, por vetëm kartëmonedha të ngarkuara veçmas në to.
	<b>Makina të tjera me të cilat operojnë klientët e bankave</b>	
4	<b>Makinat për tërheqjen e parave të gatshme (Cash Out Machines – COMs)</b>	Këto makina zakonisht janë ATM që kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave për qarkullim përpara se të tërhiqen nga klientët e bankës. COM-të përdorin kartëmonedha që i ngarkohen nga punëtorët e bankave – të cilët bëjnë përpunimin manual të kartëmonedhave ose nga sistemet tjera automatike.

2.2. Makina me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar janë:

**Tabela 2**

1	<b>Makina për përpunimin e kartëmonedhave (Banknote processing machines – BPMs)</b>	Makina të cilat kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave për qarkullim dhe fizikisht i ndajnë paratë e dyshuara dhe të pa përshtatshme nga ato autentike dhe të përshtatshme.
2	<b>Makina e autentifikimit të kartëmonedhave</b>	Makina të cilat e kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe bëjnë përzgjedhjen dhe klasifikimin e kartëmonedhave në autentike dhe të dyshimta duke hedhë të dyshuarat.
3	<b>Makina për kthimin e parave në qarkullim me ndihmën e punëtorëve arkëtarë (Teller assistant recycling Machines – TARMs)</b>	Makina me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar me anë të cilave e kontrollojnë autenticitetin dhe përshtatshmërinë e kartëmonedhave për qarkullim. Për tërheqje, TARM mund të përdorin kartëmonedha autentike dhe të përshtatshme për qarkullim të cilat i kanë deponuar klientë të tjerë në transaksionet e mëparshme. Për më tepër, ata në mënyrë të sigurt i ruajnë kartëmonedhat dhe u mundësojnë të punësuarve nëpër banka t'i miratojnë ose kreditojnë llogaritë e klientëve të bankave.
4	<b>Makina me ndihmën e punëtorëve arkëtarë (Teller assistant machines - TAMs)</b>	Me këto makina operojnë punonjës të trajnuar të cilët kontrollojnë autenticitetin e kartëmonedhave. Për më tepër, ata në mënyrë të sigurt i ruajnë kartëmonedhat dhe u



		mundësojnë të punësuarve nëpër banka t'i miratojnë ose kreditojnë llogaritë e klientëve të bankave.
--	--	---

2.3. Në raste kur klientët i depozitojnë kartëmonedhat në TARM ose TAM, ose tërheqin kartëmonedha prej tyre, këto makina duhet të konsiderohen si makina me të cilat operojnë klientët e bankave dhe duhet t'i zgjedhin dhe klasifikojnë kartëmonedhat në përputhje me aneksin II-a.

3. Banka Popullore teston lloje të ndryshme të makinave për përpunimin e kartëmonedhave. Llojet e makinave për përpunim të kartëmonedhave mund të dallohen njëra nga tjetra nëpërmjet sistemeve të tyre, zgjidhjes së softuerit dhe komponentëve të tjerë për kryerjen e funksioneve të tyre kryesore. Ato janë: për kontrollin e autenticitetit të kartëmonedhave, për zbulimin dhe ndarjen e kartëmonedhave për të cilat ekziston dyshimi se janë para të falsifikuara, për zbulimin dhe selektimin e kartëmonedhave të pa përshtatshme nga kartëmonedhat e përshtatshme, nëse është e nevojshme, edhe për përcjelljen e kartëmonedhave të identifikuar sikur të dyshimta dhe kartëmonedhave që nuk janë qartë të autentifikuara, nëse ajo është e zbatueshme.

**ANEKS II a****KLASIFIKIMI DHE TRAJTIMI I KARTËMONEDHAVE ME ANË TË MAKINAVE ME TË CILAT OPEROJNË KLIENTËT E BANKËS**

1. Klasifikimi dhe trajtimi i kartëmonedhave me anë të makinave me të cilat operojnë klientët e bankës në të cilat paratë e gatshme depozitohen me ndjekjen e klientit janë paraqitur në tabelën 3 të këtij aneksi:

**Tabela 3**

	<b>Kategoria</b>	<b>Karakteristika</b>	<b>Procedura</b>
<b>1</b>	<b>Nuk janë kartëmonedha ose nuk njihen si kartëmonedha</b>	Nuk njihen si kartëmonedha për shkak se: - kartëmonedha të cilat nuk janë denarë; - objekte të ngjashme me kartëmonedha; - imazh ose format i gabuar; - përtsherje të mëdha të cepave ose pjesë që mungojnë; dhe - gabim gjatë ngarkimit ose transferimit në makinë.	I kthehen klientit.
<b>2</b>	<b>Dyshimi për kartëmonedha të falsifikuara</b>	Identifikohen si kartëmonedha të dyshimta për shkak se imazhi dhe formati njihen, por një ose më shumë elemente të sigurisë të cilat kontrollohen nga makina, nuk mund të identifikohen ose nuk mund të tolerohen.	Tërhiqen nga qarkullimi.  Dorëzohen për autentifikim, së bashku me informacionet në lidhje me klientin pronar i llogarisë dhe veprohet sipas pikës 2, paragrafi 1, alineja 6 të këtij vendimi.  Llogaria e klientit nuk kreditohet.
<b>3</b>	<b>Kartëmonedhat të cilat nuk janë lehtë të dallueshme</b>	Imazhi dhe formati njihen, por jo të gjitha elementet e autentifikimit të kontrolluara nga makineria janë njohur për shkak të cilësisë dhe/ose deviacioneve në tolerancë. Në shumicën e rasteve këto janë kartëmonedha të papërshtatshme.	Tërhiqen nga qarkullimi.  Kartëmonedhat përpunohen ndaras dhe dorëzohen për ta autentifikim në përputhje me pikën 2, paragrafin 1, alineja 6 të këtij vendimi.  Ky informacion është i disponueshëm me kërkesë të institucioneve kompetente shtetërore. Përndryshe, në marrëveshje me institucionet kompetente shtetërore, informatat që mundësojnë

			përcjelljen e pronarit të llogarisë mund të dorëzohen në ato institucione së bashku me kartëmonedhat.  Llogaria e klientit të bankës mund të kreditohet.
4	<b>Kartëmonedhat që janë të identikuara si autentike dhe të përshtatshme për qarkullim</b>	Të gjithë kontrollet e autenticitetit dhe përshtatshmërisë për qarkullim japin rezultate pozitive.	Mund të lëshohen në qarkullim.  Llogaria e klientit kreditohet.
5	<b>Kartëmonedhat që janë të identikuara si autentike dhe të papërshtatshme për qarkullim</b>	Të gjithë kontrollet e autenticitetit japin rezultate pozitive. Të paktën një kriter i përshtatshmërisë jep rezultat negativ.	Nuk mund të lëshohen në qarkullim, duhet të kthehen në Bankën Popullore.  Llogaria e klientit kreditohet.

1.1. Makina nuk ia kthen klientit të bankës kartëmonedhat e kategorive 2 dhe 3 nga tabela numër 3, nëse makina mundëson anulimin e transaksionit të depozitave. Kartëmonedhat mund të mbahen në rast të transaksionit të anuluar, ashtu që ruhen në një pjesë të veçantë të makinës.

1.2. Makinat, të cilat kontrollojnë përshtatshmërinë e parave për qarkullim nuk duhet të bëjnë dallim midis kategorive 4 dhe 5 të tabelës numër 3.

1.3. Banka Popullore mund të negociojë me bankën se në qoftë se kartëmonedhat e kategorisë 3 në tabelën numër 3 nuk mund të ndahen fizikisht nga kategoritë 4 dhe 5 të tabelës numër 3, në këtë rast të tre kategoritë duhet të trajtohen si kartëmonedha të kategorisë numër 3 në tabelën numër 3.

## ANEKSI II b

### KLASIFIKIMI DHE TRAJTIMI I KARTËMONEDHAVE NGA MAKINAT ME TË CILAT OPEROJNË PUNONJËS TË TRAJNUAR

1. Klasifikimi dhe trajtimi i kartëmonedhave me anë të makinave të me të cilat operojnë punonjësit e trajnuar janë dhënë në tabelën të këtij aneksi, dhe atë:

Tabela 4

	Kategoria	Karakteristika	Procedura
<b>1</b>	<p><b>(1) Nuk janë kartëmonedha ose nuk njihen si kartëmonedha, ose</b></p> <p><b>(2) Kartëmonedha të dyshuara si false, ose</b></p> <p><b>(3) Kartëmonedhat të cilat nuk njihen qartë.</b></p>	<p>(1) Nuk njihen si kartëmonedha për shkak:            -kartëmonedha të cilat nuk janë denarë;            -objekte të ngjashme me kartëmonedha;            -imazh ose format i gabuar;            -përthyerje të mëdha të cepave ose pjesë që mungojnë; dhe            -gabim gjatë ngarkimit ose transferimit në makinë.</p> <p>(2) Të identifikuar si kartëmonedha të dyshimta për shkak se imazhi dhe formati janë të dukshme, por një ose më shumë elemente sigurie të kontrolluara nga makina nuk mund të identifikohen ose nuk mund të tolerohen.</p> <p>(3) Kartëmonedha të cilat nuk autentifikohen qartë sepse imazhet dhe formati janë të dallueshme, por nuk dallohen të gjitha karakteristikat mbrojtëse të cilat kontrollohen nga makina për shkak të kualitetit dhe/ose devijimeve në toleranca. Në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për para të papërshtatshme.</p>	<p>Makina i kthen kartëmonedhat tek punonjësi i trajnuar për kontroll shtesë dhe procedura të mëtutjeshme.</p> <p>(1) Objekte që nuk njihen si kartëmonedha: pas vlerësimit vizual nga punonjësit e trajnuar, këto veçohen nga kartëmonedhat e dyshuara si false dhe kartëmonedhat të cilat nuk njihen qartë.</p> <p>(2) Tërhiqen nga qarkullimi.</p> <p>Kartëmonedha të dyshimta.</p> <p>(3) Tërhiqen nga qarkullimi.</p> <p>Kartëmonedhat që nuk njihen qartë: këto përpunohen në mënyrë të veçantë dhe dorëzohen për autentifikim përfundimtar tek Banka Popullore në pajtim me pikën 2, paragrafi 1, alineja 6 të këtij vendimi.</p>

<b>2</b>	<b>Kartëmonedha e autentifikuara dhe të përshtatshme për qarkullim</b>	Të gjitha kontrollet mbi autenticitetin dhe përshtatshmërinë për qarkullim japin rezultate pozitive.	Mund të përdoren për riqarkullim.  Llogaria e klientit kreditohet.
<b>3</b>	<b>Kartëmonedhat e autentifikuara dhe të papërshtatshme për qarkullim</b>	Të gjitha kontrollet mbi autenticitetin japin rezultate pozitive. Të paktën një kriter përshtatshmërie jep rezultat negativ.	Nuk mund të kthehen në qarkullim dhe dorëzohen në Bankën Popullore.  Llogaria e klientit kreditohet.

1.1. Makinat të cilat nuk kryejnë kontrollin e përshtatshmërisë për qarkullim nuk duhet të bëjnë dallimin midis kategorive 2 dhe 3 të tabelës së dhënë.

## STANDARDE PËR KONTROLL AUTOMATIK TË KARTËMONEDHAVE

1. Standardet minimale për kontroll automatik të përshtatshmërisë së kartëmonedhave janë:

- Niveli i papranueshëm i tolerancës për kontrollin e përshtatshmërisë nga ana e makinave për përpunimin e kartëmonedhave është 5%. Kjo do të thotë që makinat mund gabimisht të klasifikojnë maksimum 5% të kartëmonedhave të cilat nuk i përmbushin kriteret e përshtatshmërisë për qarkullim si të përshtatshme për qarkullim.
- Me qëllim të kontrollit të përshtatshmërisë për qarkullim, kartëmonedhat me çfarëdo defekti në lidhje me kërkesat e detyrueshme të përcaktuara në pikën 2 të këtij Aneksi konsiderohen të papërshtatshme për qarkullim.

2. Informacionet mbi kriteret për përzgjedhjen automatike dhe klasifikimin e përshtatshmërisë së kartëmonedhave janë:

2.1. **Ndotje** - përhapja e papastërtisë përgjatë gjithë kartëmonedhës gjë që e rrit dendësinë e saj optike.

2.2. **Njollë** - përqendrim i lokalizuar papastërtie.

Kartëmonedhat me përqendrim të lokalizuar papastërtie të paktën 9mm x 9mm në zonën e pa shtypur ose të paktën 15mm x 15mm në zonën e shtypur konsiderohen të papërshtatshme.

2.3. **Vizatime** - imazh i shtuar ose shkronja të shkruara, ose shënime të çdo lloji mbi një kartëmonedhë.

2.4. **Kartëmonedhë e çngjyrosur** - mungesë e ngjyrës në një pjesë ose në të gjithë kartëmonedhën, p.sh. një kartëmonedhë e larë.

Një kartëmonedhë e çngjyrosur mund të paraqitet nëse, për shembull, është larë ose është ekspozuar ndaj përbërjeve të forta kimike. Ky lloj i kartëmonedhave të papranueshme mund të detektohen nga detektorë imazhi ose detektorë ultravioletë.

2.5 **Grisje**– kartëmonedha të cilave iu mungojnë pjesë, së bashku me të paktën një cep të grisur (për dallim nga vrimat).

Kartëmonedhat me gjatësi të reduktuar me 6 mm apo më shumë, ose gjerësi e të cilave është reduktuar me 5 mm apo më shumë, janë të papërshtatshme për qarkullim. Të gjitha matjet bëhen në raport me diferencat prej gjatësive dhe gjerësive të përshkruara të kartëmonedhave.

2.6 **Riparimi** - pjesët e një ose më shumë kartëmonedhave të bashkuara me shirit, ngjitës ose të ngjashëm.

Kartëmonedha e riparuar, e përbërë nga pjesë të kartëmonedhës, për shembull duke përdorur shirit ose ngjitës.

2.7 **Zhubra** - palosje të shumta të çfarëdoshme.

Kartëmonedhat e zhubrosura lehtë mund të identifikohen, në qoftë se niveli i tyre i reflektancës ose fortësisë është reduktuar. Nuk ekziston kërkesë të detyrueshme.

**2.8 Butësi** – Degjenerim struktural që rezulton në mungesë të theksuar të fortësisë.

Për aq sa është e mundur, kartëmonedhat me fortësi strukturale të reduktuar janë të klasifikuara si të papërshtatshme për qarkullim. Duke qenë se butësia është e lidhur me ndotjen, kartëmonedhat e buta, gjithashtu, detektohen edhe përmes detektorëve për kontrollin e ndotjes. Nuk ka kërkesë të detyrueshme.

**2.9 Grisje, vrima, palosje, qoshe të palosura** - këto terme zakonisht kanë kuptimin e përbashkët si në përdorimin e tyre të përbashkët.

Kartëmonedhat e palosura, për shkak të gjatësisë ose gjerësisë së reduktuar, mund të detektohen nga sensorë që kontrollojnë madhësinë e kartëmonedhave. Për më tepër, ato mund të detektohen edhe përmes sensorëve për trashësi.

**ANEKSI III b****STANDARDET MINIMALE PËR KRITERET E KONTROLLIT MANUAL TË KARTËMONEDHAVE**

1. Standardet minimale për kontroll manual të përshtatshmërisë së kartëmonedhave për qarkullim janë:

Në pjesën e kontrollit të përshtatshmërisë për qarkullim, kartëmonedhat me ndonjë lloj defekti, siç përcaktohet në tabelën e bashkangjitur në këtë aneks, ose me një defekt të dukshëm në njërin nga veçoritë e dukshme të sigurisë, nuk janë të përshtatshme për qarkullim. Kontrolli i përshtatshmërisë për qarkullimin bëhet me anë të kontaktit ose nëpërmjet inspektimit vizual veçmas për secilën kartëmonedhë dhe nuk kërkon përdorimin e ndonjë mjeti.

2. Kriteret e klasifikimit për kontroll manual të përshtatshmërisë janë:

	<b>Karakteristikat</b>	<b>Përshkrimi</b>
1	Ndotje	Papastërti e dukshme e shpërndarë në gjithë kartëmonedhën.
2	Njollë	Përqendrim të lokalizuar papastërtie.
3	Vizatime	Imazh i shtuar ose shkronja të shkruara, ose shënime të çdo lloji mbi një kartëmonedhë.
4	Kartëmonedhë e çngjyrosur	Mungesë e ngjyrës në një pjesë ose në të gjithë kartëmonedhën, p.sh. një kartëmonedhë e larë.
5	Grisje	kartëmonedhë me të paktën një cep të grisur.
6	Vrimë	Kartëmonedhë me të paktën një vrimë të dukshme.
7	Gjymtim	kartëmonedha të cilave iu mungojnë pjesë, së bashku me të paktën një cep (për dallim nga vrimat) p.sh. mungon një cep.
8	Riparim	Pjesët e një ose më shumë kartëmonedhave të bashkuara me shirit, ngjitës ose të ngjashëm.
9	Zhubra	Kartëmonedhë me palosje të shumta të rastësishme të cilat qartë ndikojnë në pamjen e saj vizuale.
10	Butësi	Kartëmonedhë me degjenerim struktural që rezulton në mungesë të theksuar të fortësisë.
11	Palosje	Kartëmonedhë e cila është palosur, përfshirë kartëmonedhën që nuk mund të shpaloset.
12	Cep i palosur	Kartëmonedhë të paktën me një cep dukshëm të palosur.